



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 714 Prot.

Tiranë, më 7.8.2020

Lënda: **Për kryerjen e funksioneve dhe veprimtarisë në përputhje me ligjin nga Ministria e Drejtësisë**

Drejtuar: **MINISTRIT TË DREJTËSISË**

Për dijeni: **PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

Nga adresa e Ministrisë së Drejtësisë, me urdhër dhe porosi të sekretarit të Përgjithshëm janë nxjerrë një numër i konsiderueshëm shkresash, drejtuar përmbarduesve gjyqësorë privatë.

Shkresa të tipizuara me lëndë: “*Kthim përgjigje*” janë dërguar në adresat e përmbarduesve duke kërkuar që të zbatohet prej tyre, **me rigorozitet** urdhri i ministrit të Drejtësisë me nr. 190, datë 22.6.2020 “*Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbarduesve gjyqësorë privatë*”.

**Së pari**, ju vëmendësojmë se, Ministria e Drejtësisë është institucioni që duhet të kryejë funksionet e saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Ministria që drejtoni, përveçse duhet të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën, duhet edhe të bashkëpunojë me institucionet dhe të gjitha organizatat që mundësojnë realizimin e detyrave të saj.

Shërbimet e lira juridiko - profesionale në vend, përfaqësohen nga Dhomat përkatëse.

Dhoma Kombëtare e Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë përfaqëson të gjithë përmbarduesit gjyqësorë privatë të licencuar në Republikën e Shqipërisë. Ajo përgjigjet për organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të përmbarduesit gjyqësor privat dhe ushtron veprimtarinë e saj **në mënyrë të pavarur nga shteti**. Kjo, bazuar në ligjin nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat*”.

Konstatojmë se, kërkesat dhe qëllimi i këtij ligji, nuk po kuptohen drejt nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, por as nga ana juaj si ministër i Drejtësisë.

Komunikimi i munguar institucional, mosdakordësia e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë për shumë akte nënligjore që janë nxjerrë në kundërshtim të kërkesave të ligjit, pa asnjë konsultim me Dhomën dhe së fundmi, shkuarja në gjykatë e Dhomës për të kundërshtuar gjyqësisht tre akte nënligjore të nxjerra nga ministri i Drejtësisë, janë fakte që flasin vetë.

Tentativa për të kryer procese artificiale **“vettingu”** të përmbauesve, sikundër u realizua pa asnjë sukses me noterët, nëpërmjet nxjerrjes së urdhrave me përmbajtje të paligjshme nuk është lejuar dhe **nuk do të lejohet nga Dhoma.**

**Së dyti**, sa i përket urdhrin tuaj me nr. 190, datë 22.6.2020, Dhoma Kombëtare ka dërguar qëndrimin e saj zyrtar me shkresën me nr. 695 prot., datë 3.7.2020 *“Mbi pamundësinë e zbatimit të urdhrin nr. 190, datë 22.6.2020 të ministrit të Drejtësisë deri në ndreqjen e të metave të tij. Kërkesë për bashkëpunim institucional dhe konsultim sipas kërkesave të ligjit nr. 26/2019”*.

Qëndrimi dhe mosdakordësia e Dhomës lidhur me urdhrin nr. 190 ishte e qartë: **“Çdo kërkesë për dokumente/deklarata apo vetëdeklarime jashtë atyre që kërkon ligji, është e paligjshme”**.

U kërkua para jush që, urdhri të rishikohej, të ndreqeshin gabimet dhe të ripërcillej për konsultim duke reflektuar qëndrimin zyrtar të Dhomës. Angazhimi dhe reagimi juaj institucional nuk erdhi dhe Dhoma iu drejtua me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**Së treti**, është e nevojshme t'ju parashtrijmë dhe shpjegojmë lidhur me disa fakte gjyqësore që strukturat përgjegjëse në varësinë tuaj, duket se nuk i kuptojnë.

Para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë u regjistrua çështja administrative nr. 31154-03058-80-2020, datë 23.7.2020, me palë paditëse, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, me palë të paditur, Ministria e Drejtësisë dhe person të tretë, Avokatura e Shtetit.

Objekti i gjykimit ishte:

**“1. Marrja e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbauesve gjyqësorë privatë”**

**2. Shfugizimi i aktit administrativ, urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbauesve gjyqësorë privatë”**

Në datë 27.7.2020 u zhvillua seanca gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës së Dhomës për **“Marrjen e masës së sigurimit të padisë”**.

**Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e palëve arsyetoi dhe çmoi se:** *“Duke marrë në konsideratë qëndrimet e ndryshme të palëve ndërgjyqëse lidhur me karakterin e aktit administrativ objekt të kësaj padie, Gjykata e vlerëson të rëndësishme të marrë në diskutim nëse urdhri nr. 190, datë 22.06.2020 i ministrit të Drejtësisë është akt me*

*karakter nënligjor normativ apo akt administrativ individual.[...] Në këtë mënyrë duhet theksuar fakti se rrethi i subjekteve që urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 u drejtohet, është i papërcaktuar dhe as nuk mund të përcaktohet në ndonjë mënyrë tjetër. Përmbauesit gjyqësorë privatë jo vetëm nuk janë përcaktuar nominalisht, por as nuk janë listuar në mënyrë shteruese. Duke mbajtur parasysh se ky urdhër përcakton rregulla të përgjithshme sjellje për të gjithë përmbauesit gjyqësorë privatë që punojnë aktualisht, por edhe për ata që do të licencohen si të tillë në të ardhmen, përmbaues gjyqësorë privatë që punojnë dhe veprojnë në gjithë territorin e vendit, Gjykata përfundon se akti objekt padie është akt nënligjor me karakter normativ.”*

Sa më sipër, kjo gjykatë ka vendosur në datën 27.7.2020, me vendimin nr. 1742, nr. 3281 regj.them., të deklarojë moskompetencën funksionale lidhur me çështjen administrative me nr. 3281 regj.them., datë 21.7.2020 dhe dërgimin e dosjes gjyqësore dhe akteve të saj në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ky vendim i gjykatës, është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga palët pjesëmarrëse në proces, pra dhe nga vetë Ministria e Drejtësisë.

**Duke marrë shkak nga ky zhvillim, duam të risjellim në vëmendjen tuaj parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi:**

- Në zbatim të pikës 1 të nenit 117 të Kushtetutës, Ministria e Drejtësisë duhet të bëjë **publikimin e aktit normativ nënligjor në “Fletoren zyrtare”**.

Konkretisht, dispozita kushtetuese ka përcaktuar këtë detyrim kushtetues për Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me urdhrin nr. 190, datë 22.6.2020,

*“1. Ligjet, **aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në “Fletoren zyrtare”**.*

- Ligji nr. 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, përcakton në nenin 6, pika 2, shkronja “ç)” se, në “Fletoren zyrtare” botohen *“aktet normative të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore;”*.

**Sa më sipër, ju vëmendësojmë se,**

1) Shkresat standarde “copy-paste” drejtuar përmbauesve gjyqësorë privatë, përmes së cilave kërkohet zbatimi i urdhrin nr. 190, datë 22.6.2020, të ministrit të Drejtësisë, janë të gjitha në shkelje të parashikimeve të sipërcituara kushtetuese dhe ligjore.

2) Urdhri nr. 190, datë 22.6.2020, ka parashikuar në përmbajtjen e tij se **“Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë”**.

3) Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vlerësuar moskompetencën funksionale për shqyrtimin e masës së sigurimit të padisë, për shkak se vlerëson se ky akt përbën një **“akt normativ”** dhe jo një **“akt individual”**, sipas vlerësimit paraprak të Dhomës Kombëtare.

4) Ky qëndrim i Gjykatës u arrit të formësohej nga **kërkesa e përfaqësuesit të Avokatit të Shtetit në gjykim i pakundërshtur nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë** në seancën gjyqësore.

5) Kjo nënkupton se në raport me gjykatën Ministria e Drejtësisë mban qëndrimin dhe është plotësisht e vetëdijshme se akti administrativ - urdhër nr. 190, datë 22.6.2020, i ministrit të Drejtësisë, është një akt administrativ me karakter normativ.

6) Edhe pse mban qëndrimin se rregullimet e këtij urdhri janë me karakter normativ, ministri i Drejtësisë, në shkelje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, ka nxjerrë një akt duke mos parashikuar “hyrjen në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”, por është shprehur për “hyrjen në fuqi menjëherë” të këtij akti, pa e botuar, sikur të ishte një akt me natyrë individuale.

7) Në kushtet kur,

- edhe pse masa e sigurimit të padisë për pezullimin e zbatimit të këtij akti nuk është marrë ende në shqyrtim, por Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë sipas vendimit të sipërcituar ka mbajtur një qëndrim që është ende në fuqi sa i përket natyrës së urdhrit nr. 190, datë 22.6.2020, të ministrit të Drejtësisë si një akt me karakter normativ;

- ky akt me karakter normativ nuk parashikon dispozitën e hyrjes në fuqi në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin; dhe

- nuk është botuar në “Fletoren zyrtare”;

**"jemi para rastit kur ky akt administrativ - urdhër nr. 190, datë 22.6.2020, i ministrit të Drejtësisë jo vetëm që nuk është i ligjshëm (çështje për të cilën do të shprehet gjykata), por mbi të gjitha, as nuk ka hyrë në fuqi sipas kërkesave kushtetuese dhe ligjore, referuar në vendimin e gjykatës, e cila bazuar në analizën gjyqësore të aktit, ka bërë klasifikimin e tij, si një akt normativ nënligjor.**

Për pasojë, kjo i bën të gjitha veprimet e strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, që mbështeten mbi aktin administrativ - urdhër nr. 190, datë 22.6.2020, të paligjshme dhe të gjitha shkresat e dërguara në adresë të përmbauesve gjyqësorë privatë nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, **pas daljes së vendimit të gjykatës, NUL.**

Është rasti që, si ministër i Drejtësisë, të orientoni për bashkëpunim edhe vetë strukturat brenda ministrisë, pasi Drejtoria e Përfaqësimit Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë duket se nuk ka komunikuar aspak me Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, lidhur me këtë situatë ligjore.

Sa më sipër, ju përcillet ky qëndrim për të reflektuar dhe ndrequr komunikimet shkresore të bëra në adresë të secilit prej përmbauesve gjyqësorë privatë.

**Së fundi**, sipas vendimit nr. 1742, nr. 3281 regj.them., datë 27.7.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe për sa kohë që padia e Dhomës Kombëtare nuk është shqyrtuar në themel, si dhe gjykata kompetente nuk është shprehur ende as për masën e sigurimit të padisë për pezullimin e zbatimit të aktit, në gjendjen juridike të akteve në këto momente, si ministër i Drejtësisë, **nuk legjitimoheni të drejtoni nëpërmjet strukturave të varësisë apo drejtpërdrejt asnjë kërkesë drejtuar përmbauesve gjyqësorë privatë, mbështetur në aktin administrativ - urdhër të ministrit të Drejtësisë që mban nr. 190 dhe datën 22.6.2020.**

Duke besuar se, tashmë bëhet e detyrueshme ndreqja e gabimeve të aktit dhe reflektimi institucional, për kryerjen e funksioneve dhe veprimtarisë në përputhje me ligjin,

mbetemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe realizojmë një proces të dorëzimit të dosjeve të plota personale të përmbareshve dhe të rifreskuara me dokumente të nevojshme, bazuar në formate apo të dhëna që nuk bien në kundërshtim me ligjin dhe pas konsultimit me Dhomën.

